

THOMA KACORI

NJË POEZI E ADHAM SHKABËS PËR SKËNDERBENË SHKRUAR MË 1898

Adham Shkaba kishte ardhur në Sofje nga Statobërdha e Korçës. Në fillim u muar me punë të ndryshme, pastaj bashkë me Spiro Garon hapën kafenenë «Albania», e cila u bë çerdhe e shqiptarizmit dhe vendi më i dashur i të mërguarve në Bullgari. I përfshirë nga entuziazmi patriotik që kishte rrëmbyer kolonitë e shqiptarëve të Sofjes, ai u bë një nga organizatorët dhe themelonjësit e shoqërisë patriotike «Dëshira», e cila u krijua më 1 janar 1893.

Adham Shkaba nuk ishte vetëm patriot i mirë, po dhe poet me talent. Në «Kalendarin Kombiar» si dhe te «Drita» e Shahin Kolonjës, që dilnin atëhere në Sofje, botoi shumë vjersha me motiv patriotik. Poezia e Adham Shkabës është një poezi luftarake, që grish për çlirimin e atdheut nga turku dhe kërkon zgjimin dhe bashkimin e shqipëtarëve. Poeti tregon gjendjen e mjeruar të atdheut dhe përpiqet të ngrejë popullin kundër sundonjësve duke treguar fytyrën e vërtetë të xhonturqve.

Në dorëshkrimin e vjershave të Adham Shkabës, në faqen e tretë, gjendet dhe një vjershë përmbi Skënderbenë, me titull «Shqipëria në Zi». Ajo përshkohet nga një afsh e dhëmbje e madhe që ndjehen në çdo varg. Poezia është shkruar në alfabetin e vjetër, prandaj po e japim të transkriptuar në alfabetin e sotshëm.

SHQIPËRIA NË ZI!

O Shqipëri, o mëm'e mjerë,
Pesëqint vjet ke mban zinë
Për birr'e dashur për zotn'e ndjerë,
Pa më je prishur bërë greminë.

Pesëqint vjet ka që ka ikur,
Që është ndarë nga Mëmëdheu,
Pa zemra jote djegur'e pikur
Se s'u lint tjetër si Skënderbeu.

Pesëqind vjet plot'u mbarun,
Që rri e dergjesh e mallëngjehesh
Edhe së qari syt t'u verbuan,
Se ti me fjalë nuk përdëllehesh.

S'harron dot Skëndon, trimn'e lëvduar,
 Se nat'e ditë ay lëftonte,
 Nga herë rrite me pall ndër duar
 Ty, o moj mëmë, që të të mpronte.

Foshnjë të vogël atë e ndanë
 Nga gjiri yt e nga shtëpia
 Dhe nde barbari penk seç e dhanë
 Për Mëmëdhenë, për kombn'e tia.

Atje u rrit dhe atje msojti,
 Po trimërinë vetiu e kishte,
 Sa qe atje, për ta lëftojti,
 Po nuk harrojti se nga ç'fis ishte.

U bë një trim, një Zot i naltë
 Sa mori emër në tërë botë,
 Pastaj barbarët i la në baltë,
 Ardhi nde tynë me pakë shokë.

Të parën herë qëndroi në Krujë,
 Pastaj i ardhi rreth Mëmëdheut,
 Po, si e gjeti bërë rrëmujë,
 Ju tërondi zemra fort Skënderbeut.

E zu mallngjimi, e zu të qarët,
 Po trimëria se la qetuar,
 I tha: pa ngreu e dbo barbarët
 Që Mëmëdhenë ta kan' shkretuar.

Pa u ngrit trimi e lot'i fshiu
 Edhe u hodh po si dragua,
 Barbarët i vrau, i preu, i ngriu,
 Të gjallë s'la as një po thua.

Se kordh' e ti ish si rrufeja
 Që bie mi tufë, mi lis, mi fiknë,
 Shuan sa berra që ka kopeja,
 Ashtu e shojtë ay armiknë.

Pa të dha dorën edhe të ngriti,
 Se jeshe bërë si je taninë,
 Jetënë tënde ta përtëriti
 E më çkëlqeve si vetëtimë.

Ay sa rrojti në këtë jetë,
 Ti jeshe mëma e bukurisë,
 Jeshe si ylli si hëna e vetë,
 Jeshe si kopësht'i Perëndisë.

Pastaj pas kohe fati tu thye
 Dhe bukuria iku e shkojti,
 Se vdekj'e shkretë që rri mi krye,
 Jetënë trimit ah! ja mbarojti.

E humbe Skëndon, Zotnë e ndjerë,
Pa me të iku dhe trimëria
Dhe dita jote u bë skëterrë,
Në vënt të gazit të ardhi zia.

Qaj, o Shqipri, qaj e mbaj zinë,
Kërko shpëtonjës për Mëmëdhenë,
Qaj e mallngje dhe Perëndinë
Të të dërgonjë si Skënderbenë.

